



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/08
Datë: 12.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për themelimin e Komisionit të Posaçëm për parandalim të infeksionit Corona Virus COVID-19

1. Themelohet Komisioni i Posaçëm për parandalimin e infeksionit Corona Virus COVID-19 në këtë përbërje:
 - 1.1. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës; Kryesues;
 - 1.2. Avdullah Hoti, Zëvendëskryeministër i parë; anëtar;
 - 1.3. Haki Abazi, Zëvendëskryeministër i dytë; anëtar;
 - 1.4. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë; anëtar;
 - 1.5. Agim Veliu, Ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike; anëtar;
 - 1.6. Besnik Bislimi, Ministër i Financave dhe Transfereve; anëtar;
 - 1.7. Hykmete Bajrami, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; anëtare;
 - 1.8. Anton Çuni, Ministër i Mbrojtjes; anëtar;
 - 1.9. Rozeta Hajdari, Ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike; anëtare;
 - 1.10. Emilija Redžepi, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal; anëtare;
 - 1.11. Rrahman Rama, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës; anëtar;
 - 1.12. Valon Prestreshi, Kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës; anëtar;
 - 1.13. Fadil Kodra, Kryeshef i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent; anëtar;
 - 1.14. Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës; anëtar;
 - 1.15. Rashit Çalaj, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës; anëtar;
 - 1.16. Ibrahim Xhaka, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Doganës; anëtar;
 - 1.17. Valdet Gjinovci, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; anëtar;
 - 1.18. Përfaqësues i Inspektoratit të Shëndetësisë; anëtar;
 - 1.19. Përfaqësues i Inspektoratit Farmaceutik; anëtar;
 - 1.20. Përfaqësues i Inspektoratit të Tregut; anëtar;
 - 1.21. Përfaqësues i Inspektoratit të Punës; anëtar;
 - 1.22. Përfaqësues i Departamentit për Rezerva Shtetërore; anëtar.
2. Komisioni ka detyrë ta menaxhojë procesin e parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19 në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë edhe kontrollin e zbatimit të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore për mbrojtjen e konsumatorëve përmes organeve të autorizuara të Administratës shtetërore.

3. Të gjitha bizneset përfshirë, por pa u kufizuar, si farmacitë dhe bizneset tjera që ofrojnë produkte ushqimore dhe higjienike obligohen të operojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe të mos abuzojnë me çmime të produkteve medicinale dhe ushqimore.
4. Të gjitha institucionet janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ta ndihmojnë Komisionin për kryerjen e detyrave të tij.
5. Komisioni do të mbikëqyrë punën e të gjitha institucioneve relevante që janë në kompetencë të Qeverisë dhe të koordinohet me institucionet tjera kushtetuese sipas rastit.
6. Komisioni ndër të tjera, siguron që:
 - 6.1. Materialet e domosdoshme të shpërndahen nëpër qendrat mjekësore në të gjitha komunat, te policia, doganierët, policët kufitarë dhe të gjitha shërbimet tjera emergjente;
 - 6.2. Të përgatiten objektet e nevojshme në rast nevojë për vendosjen e personave të prekur;
 - 6.3. Hyrjet/daljet e qytetarëve nga Kosova të kontrollohen nga personeli shëndetësor;
 - 6.4. Bizneset të kryejnë punën e tyre me nder e përgjegjësi, të mos lëvizin çmimet, dhe institucionet përkatëse të kryejnë kontrollet në terren (në markete, në farmaci dhe pika të tjera ku ofrohen materialet bazike) bazuar në kompetencat ligjore që kanë në situata të tilla;
 - 6.5. Të ketë komunikim me mediat publike dhe private, duke kontribuar në informim të drejtë e të plotë të qytetarëve për masat që duhet ndërmarrë, por duke mos shkaktuar panik;
 - 6.6. Qytetarëve t'u ofrohen njoftimet dhe udhëzimet nga ana institucioneve përgjegjëse, që të veprojnë sipas tyre;
 - 6.7. Të kryejë edhe detyra të tjera të cilat kërkohen varësisht nga rrethanat e krijuara.
7. Komisioni është i obliguar t'ia propozojë Qeverisë për miratim masat parandaluese sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me pikën 6. të këtij vendimi.
8. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Komisionit mund të ftojë ekspertë edhe përfaqësues të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.
9. Obligohen të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces për ofrimin e të dhënave dhe zbatimin e masave të kërkuara nga Komisioni.
10. Komisioni i Raporton Qeverisë në baza të rregullta ditore dhe sipas kërkesës.
11. Sekretariati Koordinues i Qeverisë i ofron mbështetje administrative Komisionit.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë